

VENDIM
Nr. 341, datë 4.5.2016

**PËR MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE
KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË, PËR DHËNIE ME KONCESION PËR
NDËRTIMIN E ADMINISTRIMIN E IMPIANTIT TË TRAJTIMIT TË MBETJEVE
URBANE TË QARKUT FIER DHE PRODHIMIN E ENERGJISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 25, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e bonusit prej 10 (dhjetë) % të pikëve, që i jepet shoqërisë “*Building Construction & Green Energy*” për rezultatin teknik e financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënien me koncesion të ndërtimit e administrimit të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë.

2. Ngarkohet Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama